

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z./Znj. _____

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Novobërdës:

F T O J

Mbledhjen e pestë të Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më **15.10.2020** (e enjte) duke filluar në orën **11:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Raportim për fillimin e vitit shkollor 2020/21;
3. Njoftim nga zyra për komunitete dhe kthim;
4. Të ndryshme;


Me: 12.10.2020
Në: Novobërdë

Shpresa Kqiku
Kryesuese e Komitetit për Komunitete





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e katërt e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 15.09.2020, duke filluar në orën 11:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Komitetit për komunitete Shpresa Kqiku, Anëtarët e Komitetit: Dobrivoje Djordjovic, Aleksander Pavic, Zymer Zymeri, Abdyl Gashi, Jorgovanka Filic, Behare Jashari.

Kryesuesja e Komitetit pasi përshendeti të pranishmit e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Diskutim rreth situates me pandemi COVID-19 në Komunë;
3. Njoftim nga zyra për Komunitete dhe Kthim;
4. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a kan ndonjë propozim apo pajtohen me këtë rend dite?

Pasi nuk pati propozime aprovohet njëzëri rendi i ditës nga anatrët prezent të Komitetit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;

Kryesuesja e hapi diskutimin rreth kësaj pike.

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet njëzëri nga të gjithë antarët prezent procesverbali i mbledhjes së kaluar.

Pika e dytë: Diskutim rreth situates me pandemi COVID-19 në Komunë;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi pasi përshendeti të pranishmit tha: jam antarë i shtabit emergjent dhe kemi pasur një bashkpunim shumë të mirë me të gjithë antarët e këtij shtabi, kemi pasur rast të vizitojm familjet dhe të ju dalim në ndihm familjeve por fatkeqësisht nuk kemi mbajtur takim më shumë se një muaj nuk e di pse nuk është thirr, por është rendi që të mbahet takimi pasi që këtë javë kanë filluar edhe shkollat mësimin. Jo vetem në Komunën tonë por pothuajse në të gjithë Komunat situata ka dal prej Kontrollit. Kishte qenë mire që të fillojm me mbajtje të takimeve të rregullta ashtu siç kemi filluar prej muajit mars, kemi pasur rastin që të vizitojm disa familje dhe ka shumë që janë në varfëri ekstreme, ka shumë familje të varfëra dhe që kanë shumë nevoj për ndihmë dhe nuk ju ndihmon askush, nese ka dikush ndonjë vërejtje është mirë që të ma thuani dhe në rast se mbajm mbledhje e percjell te të gjithë antarët e shtabit emergjent, ju faleminderit.

Dobrivoje Djordjevic pasi përshendeti të pranishmit tha: mendoj se as Kuvendi dhe as këshilli egzekutiv nuk janë duke e kryer punën e vet si duhet, në pjesen e poshtme të Komunës, fshtarta si Stanishir, Koretishtë, Kufc ka qenë gjendje e jashtëzakonshme, sipas disa informatave kanë qenë mbi 100 raste të infektuar. As Komuna, as Këshilli emergjent nuk kanë dhënë informata për numrin e të infektuarve, besoj që as nuk kanë informata se sa është numri i të infektuarve ose sa ka qenë. Edhe pse kanë qenë të infektuar kanë dal kanë shetitur dhe askush nuk i ka ndaluar as nuk ju është dhënë

ndonjë vërejtje prej askujt, me ligj nese nje antarë i familjes është i infektuar e gjithë familja duhet të vetizohet andaj mendoj se Komuna jonë ka deshtuar në mbikqyrjen e kësaj situate.

Abdyl Gashi tha: më shumë se një muaj nuk kemi mbajtur takim dhe në takimin e fundit kemi marrë vendim që ti vizitojm familjet, nese shtabi e ka një list të të gjithë të infektuarve atëher policia duhet ti vizitoj dy herë në ditë.

Dobriroje Djordjevic tha: a keni informata se në cilat fshtara ka më shumë raste të infektuar?.

Abdyl Gashi tha: ka pasur 4 raste në fshatin Pasjak nese nuk gabo, tjerat raste kanë qenë në Kufc, Koretishtë, Stanishor.

Dobriroje Djordjevic tha: unë ju tregova se në bazë të ligjit në fuqi nese një person është i infektuar e gjithë familja duhet të karantinohet, Komuna e Novobërdës nuk e ka kryer punën si duhet dhe asnjë familje nuk ka pasur në Karantinë.

Behare Jashari pasi pershendeti të pranishmit tha: pajtohem me diskutimin e kolegut se Komuna e Novobërdës nuk e ka kryer punën ashtu si duhet dhe nuk ka ndihmuar askënd. Gjatë periudhes së karantinimit kemi pasur probleme me maska, dikush nuk ka pasur transport që të shkoj dhe të blej maska e dikush nuk ka pasur mjete që të blejë

Aleksander Pavic pasi pershendeti të pranishmit tha: pajtohem me kolegun Dobrirojen dhe Abdylin pasi që nuk kan pasur informata zyrtare për ato fshatra por të gjithë kemi degjuar se ka pasur shumë raste, edhe pse kanë qenë të infektuar kanë shetitur kanë dal në qytet, policia kanë qenë por nuk e kan kryer punën e vet ashtu siç duhet. Këmi pasur rast në fshatin Koretishtë i cili ka perfunduar me vdekje. Kur kanë filluar të miren masat për mbrojtje nga pandemia policia ka hasur në qytetarë që si kan vendosur maskat dhe ata persona janë denuar në vlerë prej 25-35€, ka pasur raste që policia ka intervenuar ndersa ka pasur raste që nuk e ka kryer punën e vet si duhet.

Jorgovanka Filic pasi pershendeti të pranishmit tha: po e shoh se këtu po sulmohet pushteti, policia, por fajin ryesor e kemi ne si qytetarë, ne duhet të jemi më të ndergjegjshëm. Ka qenë i formuar shtabi emergjent dhe të gjithë qytetraët që kanë kerkuar ndihmë janë ndihmuar, nuk është e veretet se nuk është ndihmuar asnjë familje, është e pamundur që të vizitohen të gjitha familjet por ato familje që kanë kerkuar ndihmë janë vizituar por ne qytetarët nuk jemi mjaftueshëm të ndergjegjshëm.

Dobriroje Djordjevic tha: unë e ceka se Komuna nuk e ka kryer punën e vet ashtu siç duhet dhe kjo gjë mua po më brengos, ka pasur raste në Komunat tjera si Komuna e Kamanices ku ka pasur raste dhe e gjithë familja është karantinuar.

Behare Jashari tha: i kam parë në faqe të Komunës së Novobërdës në facebook se janë ndihmuar disa familje por janë ndihmuar vetem familjet e komunitetit serb.

Zymer Zymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: shyqyr Zotit qe skemi pasur shumë raste ne Komunën e Novobërdës sa për Komunën tonë, policin ose shtabin emergjent kishem vdek të gjithë, së pari policia e Kosovës nuk e ka kryer punën e vet dhe asnjë shtepi Kryetari i Komunës nuk e ka vizituar te shqiptarët.

Pika e tretë: Njoftim nga zyra për Komunitete dhe Kthim;

Kryesuesja tha: pasi që prezantuesja e kësaj pikë nuk është këtu, këtë pikë e shtym për mbledhjen e ardhshme.

Dobriroje Djordjevic tha: për të gjithë antarët e komitetit, shefja e zyres u ankojke se spo ja aprovojm planin dhe nuk do tja aprovojm pasi që ajo nuk ka ardhur në mbledhje që të raportoj, prandaj kush nuk na respekton nuk e respektojm as ne, ajo qenka në pushim por janë puntorët e saj aty.

Kryesuesja tha: hera e parë është që mungon shefja e ZKKK në mbledhje të komitetit.


Pika e katërt: të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: për mbledhjen e ardhshme kishe qenë mirë që të futet kjo pikë për rend dite:
Raportimi për fillimi e vitit shkollor 2020/2021.
Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi ne ora 12:00.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Shpresa Kqiku
Kryesuese i Komitetit për Komunitete

